



Njoftim për shtyp

Alpha Bank Albania dhuron një aparat ekografie për Spitalin Onkologjik Tiranë.

Në kuadër të përgjegjësisë shoqërore dhe angazhimit publik, Alpha Bank Albania zgjodhi të dhurojë 25 000 Euro, për blerjen e një aparati ekografie për Spitalin Onkologjik në Tiranë, e cila do të përdoret për kryerjen e diagnozave në kohën e duhur të sëmundjeve të ndryshme kancerogjene.

Ky dhurim vjen nga të ardhurat e gjeneruara nga përdorimi i kartave të kreditit të lëshuara nga Alpha Bank Albania. Gjatë muajit për rritjen e ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, Alpha Bank Albania nisi fushatën ndërgjegjësuese “Jemi të gjithë luftëtarë kundër kancerit të gjirit”, duke u bërë thirrje të gjithë kartëmbajtësve të mbështesnin këtë fushatë, nëpërmjet përdorimit të kartave të kreditit të lëshuara nga Alpha Bank Albania.

Në një konferencë për shtyp, të mbajtur në mjediset e QSUT, znj. Ogerta Manastirliu, Drejtore e QSUT, shfaqti mirënjohjen e saj për këtë kontribut, që do të ndihmojë në mënyrë të drejtpërdrejtë pacientë të moshës 15-80 vjeç, pavarësisht gjinisë së tyre (aktualisht statistikisht tregojnë se rreth 70% e pacientëve janë femra).

“Në kuadër të programit “Së bashku kundër kancerit”, Alpha Bank Albania i ka mundësuar qendrës spitalore t’i shtohet një pajisje e re, me shumë vlerë në aspektin diagnostik dhe atë të ndjekjes së pacientit në patologjitë tumoriale. Dua të falenderoj Alpha Bank Albania dhe uroj që këto nisma t’i bashkohen edhe repartëve të tjera të Qendrës Spitalore Universitare Tiranë, sepse është shumë i rëndësishëm solidariteti i treguar, për sëmundje që kanë nevojë për përkrahje në të gjithë sferat. Aparati i ri që i shtohet Shërbimit të Onkologjisë padyshim përmirëson cilësinë e shërbimit, pasi ofron diagnostikim në disa aspekte dhe jemi shumë të kënaqur që në Shërbimin Onkologjik është shtuar një pajisje e re” është shprehur drejtoresha e QSUT në fjalën e saj.

Shtimi i numrit të pajisjeve ekografike ka një rëndësi thelbësore për spitalet, duke qenë se ato ndihmojnë personelin mjekësor që të kryejë më shumë kontrolle, e si rrjedhim të shpëtojë më shumë jetë njerëzish.

Znj. Erjona Çela, Drejtore e Divizionit të Huadhënies për Ekonomitë Familjare në Alpha Bank Albania, shprehu kënaqësinë se ky fond do të shërbejë për një çështje shumë të rëndësishme për shoqërinë, siç është shëndeti i njerëzve.

“Përgjegjësia shoqërore është një ndër prioritetet e Alpha Bank Albania. Ne ndihemi të përkushtuar që të jemi gjithnjë në vijën e parë për nisma të ngjashme. Këtë ditë, do të doja të ftoja shqiptarët që të kryejnë kontrolle mjekësore periodike, me qëllim parandalimin e sëmundjeve. Siç ka thënë edhe humanisti i shquar Erazmi i Roterdamit, “Parandalimi është më i mirë se kurimi” – tha znj. Çela.



ALPHA BANK

Sipas të dhënave zyrtare, çdo vit në Shqipëri ka një trend rritës përsa i përket numri të pacienteve të diagnostikuar me kancer. Shqetësimi më i madh është se pacientët kryejnë ekzaminimet vetëm kur sëmundja është në një stad të avancuar, duke zvogëluar në këtë mënyrë mundësinë e ndërhyrjes dhe kurimit. Ekografia ndihmon zbulimin në një fazë shumë të hershme të sëmundjeve kancerogjene dhe si rrjedhim të bëhet i mundur mjekimi i tyre.

Alpha Bank Albania është pjesë e Grupit Alpha Bank, themeluar që prej vitit 1879 dhe është një nga bankat dhe grupet financiare kryesore në Greqi, duke i ofruar një gamë të gjerë shërbimesh, individëve, SME-ve, korporatave, nëpërmjet kartave të kreditit, drejtimit të aktiveve, veprimtarive bankare të investimit, veprimtarive bankare vetjake, veprimtarive të ndërmjetësit, leasing dhe factoring, etj. Alpha Bank është gjithashtu aktive në tregun ndërkombëtar bankar, me prani në Qipro, Rumani, Bullgari, Serbi, Shqipëri, Maqedoni dhe Mbretërinë e Bashkuar.

